



 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPOUE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep. Dep. Dep. Nr. i flet. Broj stranica Nr. pages	DPK 02	Nr Prot. Br Prot. Prot No	03-02-12-12-17
Data Datum Date		04.05.2017	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.05.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-02-4404/16, për znj. Elhame Shefkiu, Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm të gjendjes së konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Elhame Shefkiu, Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” dhe njëkohësisht inxhiniere në Community Development Initiative - CDI, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas pranimit të informatës me pretendimet për konflikt interesi sipas të cilës znj Shefkiu punon në funksionin inxhiniere në CDI dhe me këtë kompani ka fituar kontratë nga Qeveria Zvicerane për ndërtimin e ujësjellësit përfshiat e Gjilanit, zyrtarja e lartë, fillimisht është njostuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, përfillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkresë kemi organizuar një takim me zyrtaren e lartë.

Gjatë këtij takimi zyrtarja e lartë znj. Shefku ka deklaruar se është e punësuar me kontratë në funksionin inxhinierë në CDI. Ndërsa kjo organizatë është konsorcium me kompaninë gjermane Dorch e cila ka fituar kontratë nga Qeveria Zvicerrane për implementimin e programit të fazës së pestë të programit rural për furnizim me ujë dhe sanitari në gjashtë ndërmarrje rajonale të ujësjellësit.

Agjencia kundër Korruptionit ka siguruar informacione lidhur me këtë çështje sipas të cilës ndërmarrjet publike dhe komunat aplikojnë për financimin e projekteve për rehabilitimin e ujësjellësit në CDI. Pas vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve nga komisioni vlerësues sipas kritereve të përcaktuara, dërgohen në Këshillin Drejtues për aprovim të projekteve të cilat do të financohen nga Qeveria Zvicerrane në partneritet me Qeverisë e Republikës së Kosovës. Pastaj fillon faza e implementimit të projekteve nga CDI duke filluar nga fizibiliteti, kontraktimi i kompanive për projektimin e projekteve, zhvillimi i procedurës së prokurimit nga ndërmarrja publike, përzgjedhja e kompanive për kryerjen e punimeve, dhe përzgjedhja e kompanisë për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve. Ndërsa CDI për punën e vetë mbikëqyret nga zyra zvicerrane dhe komiteti drejtuesi cili është organ Vendimarrës.

Ushtrimi i funksionit Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” dhe njëkohësisht inxhinierë në CDI- nuk paraqet konflikt interesit sepse znj. Shefku nuk i mbikëqyr projektet në ndërmarrjen ku edhe e ushtron funksionin publik, dhe nuk është e përfshirë në Vendimarrje lidhur me këto projekte.

Zyrtarja e lartë znj. Shefku nuk mund të mbikëqyr projektet që lidhen me ndërmarrjen publike në të cilën ushtron funksionin publik. Gjatë ushtrimit të funksionit publik eventualisht mund të paraqitet ndonjë konflikt rast për rast i interesit, atëherë zyrtarja e lartë duhet të deklaroj konfliktin e interesit dhe të tërhoqet nga vendimmarrja neni 13 (paragrafi 1,2,3) të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

